

Si rezultat i kësaj politike dhe aktiviteti të drejtpërdrejtë, bashkëpunimi me kompanitë e huaja për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës në Shqipëri, tashmë, është në vitin e 15^{te} të tij.

Në përmbledhje të këtij aktiviteti, krahas të tjerave, sot kemi:

11 puse kërkimi të shpuar, me një metrazh të përgjithshëm 38.498 ml (nga të cilët 6 në det, me një metrazh rreth 21,629 ml dhe 5 në tokë, me një metrazh rreth 16,869 ml);

13 mijë km profile të rinj sizmikë, pa përmendur vrojtimet gravimetrike, magneto-telurike, të gjeokimisë sipërfaqësore, etj.;

Për realizimin e gjithë këtyre punimeve janë shpenzuar në total (tokë+det), më shumë se 385 milionë USD.

Puna e mirë e berë në vite dhe ky volum i madh operacionesh hidrokarbure, të bazuara në investimet e mësipërme, ka ndihmuar në sqarimin e situatës prognozë të zbulimit të rezervave të reja hidrokarbure.